



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

1. **RADIOTELEVISIONIT TË KOSOVËS**, me adresë në Rr. "Xhemajl Prishtina", Nr.12., Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Drejtoresha e Përgjithshme **Zana Spahiu**, në tekstin e mëtejshme referuar si: "RTK", në njërën anë;  
Dhe
2. **QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS**, me adresë në Rr. "UÇK", Nr. 273, 10000, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Drejtoresha **Blerta Zeqiri**, në tekstin e mëtejshme referuar si: "QKK", në anën tjetër.

## PREAMBULË

Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Ligjin Nr. 08/L-202 për Kinematografinë, si dhe interesin e përbashkët për zhvillimin, promovimin dhe ndërkombëtarizimin e industrisë filmike dhe audio-vizuale të Republikës së Kosovës.

Duke vlerësuar rolin e RTK-së si transmetues publik në promovimin e kulturës, artit dhe identitetit kulturor të Kosovës, si dhe duke njohur rolin e QKK-së në mbështetjen dhe zhvillimin e kinematografisë kosovare, palët bien dakord si në vijim:

### Neni 1

#### Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është krijimi i një kornize bashkëpunimi ndërmjet RTK-së dhe QKK-së për mbështetjen, promovimin dhe zhvillimin e veprimtarisë filmike audio-vizuale në Republikën e Kosovës.

Bashkëpunimi synon rritjen e prezencës së RTK-së në prodhime dhe bashkëprodhime filmike, promovimin e filmit kosovar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik mediatik dhe industrisë filmike, si dhe promovimin e kulturës dhe identitetit shtetëror të Republikës së Kosovës.

### Neni 2

#### Parimet e bashkëpunimit

Palët do ta realizojnë bashkëpunimin mbi bazën e ligjshmërisë, interesit publik, transparencës, profesionalizmit, pavarësisë institucionale, lirisë artistike dhe krijuese, si dhe barazisë së trajtimit të subjekteve të industrisë filmike.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO



QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS  
CENTAR ZA KINEMATOGRAFIJU KOSOVA  
KOSOVA CINEMATOGRAPHY CENTER

### Neni 3

#### Fushat e bashkëpunimit

Palët do të bashkëpunojnë në:

- prodhime dhe bashkëprodhime filmike;
- promovimin e veprave audio-vizuale kosovare;
- mbulimin mediatik të festivaleve dhe ngjarjeve filmike;
- organizmin e aktiviteteve profesionale dhe edukative;
- promovimin ndërkombëtar të filmit kosovar;
- ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë filmike të Kosovës;
- promovimin e Kosovës si destinacion për xhirime (film destination) e nxitjen e investimeve në industrinë audiovizuale;
- projekte të tjera që palët i konsiderojnë me interes të përbashkët dhe që kontribuojnë në zhvillimin e sektorit kinematografik dhe audiovizual, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 4

#### Të drejtat dhe obligimet e RTK-së

1. RTK mund të marrë pjesë si partner mediatik, bashkëprodhues ose mbështetës i projekteve filmike në përputhje me misionin publik, legjislacionin në fuqi dhe mundësitë buxhetore.
2. Mund të ofrojë mbështetje financiare, teknike, logjistike, promovuese ose programore për projekte të caktuara.
3. Promovon veprat filmike kosovare përmes platformave të saj televizive, radiofonike dhe digjitale.
4. Mundëson mbulim mediatik të ngjarjeve dhe festivaleve filmike me interes publik.
5. Emëron përfaqësuesit e saj në mekanizmat e përbashkët koordinues.
6. Gëzon të drejtën e transmetimit të projekteve ku merr pjesë, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet e veçanta.
7. Ka të drejtë të përdorë materialet promovuese të projekteve ku merr pjesë për nevoja programore dhe promovuese.
8. RTK në përputhje me misionin e saj publik, mund të sigurojë hapësirë programore për promovimin e veprave audio-vizuale kosovare, aktiviteteve filmike, festivaleve dhe ngjarjeve të tjera me interes për zhvillimin e kinematografisë, në përputhje me politikat programore dhe editoriale të RTK-së.

### Neni 5

#### Të drejtat dhe obligimet e QKK-së





RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO



1. QKK bashkëpunon me RTK-në në identifikimin dhe promovimin e projekteve me interes për zhvillimin e kinematografisë kosovare.
2. Informon RTK-në për aktivitetet, festivalet dhe projektet me rëndësi të veçantë për sektorin filmik.
3. Mundëson qasje në materialet promovuese dhe informative për nevoja të transmetimit dhe promovimit.
4. Promovon RTK-në si partner institucional në projektet ku RTK kontribuon si bashkëprodhues ose partner mediatik.
5. Emëron përfaqësuesit e saj në mekanizmat e përbashkët koordinues.
6. Gëzon të drejtën të propozojë iniciativa dhe projekte për bashkëpunim institucional.

#### **Neni 6** **Bashkëprodhimi**

1. Palët mund të bashkëpunojnë në projekte të veçanta filmike përmes marrëveshjeve të posaçme.
2. Çdo projekt bashkëpunimi do të rregullohet me kontratë të veçantë.
3. Kontrata e veçantë përcakton:
  - a) kontributet financiare;
  - b) të drejtat dhe detyrimet e palëve;
  - c) të drejtat e transmetimit;
  - d) përdorimin e logos dhe identitetit institucional;
  - e) afatet e realizimit;
  - f) çështjet e pronësisë intelektuale;
  - g) mënyrën e menaxhimit, raportimit dhe monitorimit të projektit;
  - h) çështje të tjera që palët i konsiderojnë të nevojshme për zbatimin e projektit.
4. Kjo marrëveshje nuk përbën bazë për financim automatik të asnjë projekti.

#### **Neni 7** **Promovimi Ndërkombëtar**

1. Palët do të bashkëpunojnë në promovimin e filmit Kosovar në festival, tregje filmike dhe ngjarje ndërkombëtare.
2. RTK mund të ofrojë mbështetje mediatike për prezantimin ndërkombëtar të projekteve filmike kosovare.
3. Palët do të nxisin krijimin e partneriteteve me transmetues publik, institucione kulturore dhe organizata ndërkombëtare.



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO



QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS  
CENTAR ZA KINEMATOGRAFIJU KOSOVA  
KOSOVA CINEMATOGRAPHY CENTER

#### **Neni 8**

#### **Të drejtat e pronësisë intelektuale**

1. Të drejtat autoriale dhe të drejtat e lidhura me to rregullohen sipas legjislacionit në fuqi dhe kontratave të veçanta.
2. Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshje nuk nënkupton transferim të të drejtave autoriale ndërmjet palëve.
3. Kushtet e shfrytëzimit të veprave audio-vizuale do të përcaktohen për secilin projekt veç e veç.

#### **Neni 9**

#### **Grupi i Përbashkët Koordinues**

1. Për zbatimin e kësaj marrëveshje themelohet Grupi i Përbashkët Koordinues.
2. Grupi përbëhet nga numër i barabartë përfaqësuesish të RTK-së dhe QKK-së.
3. Grupi monitoron zbatimin e marrëveshjes, propozon aktivitete të përbashkëta, identifikon mundësi bashkëpunimi dhe harton raporte periodike për palët.

#### **Neni 10**

#### **Dispozitat financiare**

1. Kjo marrëveshje nuk krijon obligime financiare automatike për asnjërën palë.
2. Çdo angazhim financiar realizohet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi, buxhetet e miratuara dhe marrëveshjet përkatëse.

#### **Neni 11**

#### **Kohëzgjatja**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
2. Marrëveshja lidhet për një periudhë prej tri (3) vitesh.
3. Palët mund ta vazhdojnë, ndryshojnë ose plotësojnë marrëveshjen me pajtim të ndërsjellë me shkrim.

#### **Neni 12**

#### **Ndërprerja e Marrëveshjes**

1. Secila palë mund të ndërpresë këtë Marrëveshje në mënyrë të njëanshme, duke njoftuar me shkrim palën tjetër së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para datës së ndërprerjes.
2. Ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje nuk ndikon në vlefshmërinë dhe zbatimin e marrëveshjeve, kontratave ose obligimeve të veçanta të marra para datës së ndërprerjes, përveç nëse palët pajtohen ndryshe me shkrim.





RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVISIONI KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO



3. Në rast të shkeljes së rëndë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, pala e dëmtuar mund të kërkojë ndërprerjen e menjëhershme të saj, pas njoftimit me shkrim dhe dhënies së një afati prej tridhjetë (30) ditësh për eliminimin e shkeljes.
4. Ndërprerja e Marrëveshjes nuk i liron palët nga detyrimet financiare, kontraktuale ose ligjore të krijuara para datës së ndërprerjes.

#### Neni 13

##### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Palët do të angazhohen që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ta zgjidhin në mënyrë miqësore përmes konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta.
2. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet përmes konsultimeve brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit me shkrim të mosmarrëveshjes, secila palë ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë.

#### Neni 14

##### Dispozitat Përfundimtare

1. Çdo ndryshim ose plotësim i kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim dhe me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.
2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.
3. Marrëveshja nënshkruhet në dy (2) ekzemplarë origjinalë me fuqi të njëjtë juridike, nga një për secilën palë.

**Kjo marrëveshje u nënshkrua në Prishtinë, më 05.08.2026**

**Nënshkrimet e palëve kontraktuese:**

**Zana Spahiu**

**Drejtoreshë e Përgjithshme e  
Radiotelevizionit të Kosovës**

**Blerta Zeqiri**

**Drejtoreshë e  
Qendrës Kinematografike të Kosovës**